



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

**Projektregullore**  
**Për Regjistrimin dhe Administrimin e Emrave të Domain-eve**  
**“.al, .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al**

**Dokument për Këshillim Publik**

Miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr.12 datë 16.04.2026

# Përmbajtja

<b>KAPITULLI I - TË PËRGJITHSHME</b>	<b>4</b>
Neni 1 Përkufizime	4
Neni 2 Qëllimi	5
Neni 3 Zbatueshmëria	5
Neni 4 Kushtet dhe kërkesat e përgjithshme	5
<b>KAPITULLI II - RREGULLAT QË LIDHEN ME EMRAT E DOMAIN-EVE</b>	<b>6</b>
Neni 5 Rregullat Sintaksore	6
Neni 6 Kategoritë e domain-eve	7
Neni 7 Të drejtat e emrit të domain	7
Neni 8 Mbrojtja e të drejtave të mëparshme	8
Neni 9 Emrat e ndaluar dhe të rezervuar	9
Neni 10 Zgjedhja e emrit të domain-it	10
<b>KAPITULLI III - REGJISTRI</b>	<b>10</b>
Neni 11 Roli i Regjistrimit	10
Neni 12 Të dhënat e detyrueshme për regjistrimin e emrit të domain-it	11
Neni 13 Kompetencat e Regjistrimit mbi të dhënat e regjistrimit	12
<b>KAPITULLI 4 - REGJISTRUESIT</b>	<b>13</b>
Neni 14 Roli i Regjistruesve	13
Neni 15 Akreditimi i Regjistruesve	13
Neni 16 Përgjegjësitë e Regjistruesve	13
Neni 17 Saktësia e të dhënave	14
<b>KAPITULLI 5 - RREGULLAT PËR ZOTËRUESIN E DOMAIN-IT</b>	<b>14</b>
Neni 18 Zotëruesi i një emri domain-i në zonën “.al”	15
Neni 19 Kontakti administrativ dhe kontakti teknik	15
Neni 20 Përgjegjësitë e zotëruesit të emrit të domain-it	15
<b>KAPITULLI 6 - VEPRIMET ME EMRAT E DOMAIN-EVE</b>	<b>16</b>
Neni 21 Regjistrimi i një emri domain	16
Neni 22 pezullimi i një emri domain	16
Neni 23 Bllokimi i një emri domaini	17
Neni 24 Fshirja e një emri domain	17
Neni 25 Transferimi vullnetar	18
Neni 26 Transferimi i detyrueshëm	18
Neni 27 Ndryshimi i regjistruesit	19

Neni 28 Emrat e domain-it pa regjistrues	19
<b>KAPITULLI 7 - ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE</b>	<b>20</b>
Neni 29 Rastet e Ankesave	20
Neni 30 Trajtimi i ankesave nga AKEP	Error! Bookmark not defined.
<b>KAPITULLI 8 - TË DHËNAT PERSONALE DHE KONFIDENCIALITETI</b>	<b>21</b>
Neni 31 Konfidencialiteti dhe të dhënat personale	21
Neni 32 Shërbimi RDAP	22
<b>KAPITULLI 9 - DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT</b>	<b>23</b>
Neni 33 Dispozita kalimtare për implementimin teknik	23
Neni 34 Shfuqizime	23
Neni 35 Hyrja në fuqi dhe zbatimi	24
<b>ANEKS 1. REGJISTRIMI I DOMAINEVE “.GOV.AL” DHE “.MIL.AL”</b>	<b>25</b>
<b>ANEKS 2. AKREDITIMI DHE DETYRIMET E REGJISTRUESIT</b>	<b>28</b>

# KAPITULLI I TË PËRGGJITHSHME

## Neni 1 Përkufizime

Për zbatimin e kësaj Rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “AKEP” – Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, i cili ushtron funksionin e regjistrimit për emrat e domain-eve nën ccTLD “.al”.
2. “Aplikuesi” – çdo individ, subjekt person fizik që ushtron aktivitet tregtar, subjekt juridik publikë ose privat, shqiptar ose i huaj, që paraqet kërkesë për regjistrimin ose transferimin e një emri domain-i.
3. “Autoritete kompetente” – organet publike që, në përputhje me legjislacionin në fuqi, kanë të drejtë të kërkojnë ndërhyrje mbi emrat e domain-eve.
4. “Bllokim” – çaktivizimi i funksionimit të një emri domain-i në DNS dhe ndalimi i çdo veprimi mbi të.
5. “DNS (Domain Name System)” – sistemi që mundëson përkthimin e emrave të domain-eve në adresa IP.
6. “Domain pa regjistruar (orphan domain)” – emër domain-i për të cilin regjistruesi nuk është më në gjendje të ofrojë shërbim.
7. “Emër domain-i” – identifikues unik alfanumerik i regjistruar në regjistër dhe i përdorur për adresimin në internet.
8. “Fshirje” – heqja e një emri domain-i nga regjistri dhe kthimi i tij në gjendje të lirë për regjistrim.
9. “Gjendje (status)” – gjendja operative e një emri domain-i në regjistër, e cila përcakton veprimet që mund të kryhen mbi të.
10. “IDN” (international domain names) - emra domain ndërkombëtarë
11. “Lista e emrave të ndaluar” – lista e emrave të domain-eve që nuk lejohen të regjistrohen në asnjë rrethanë.
12. “Lista e emrave të rezervuar” – lista e emrave të domain-eve që mund të regjistrohen vetëm pas verifikimit ose miratimit paraprak nga AKEP.
13. “Pezullim” – masë e përkohshme që kufizon kryerjen e veprimeve administrative mbi një emër domain-i pa ndikuar në funksionimin teknik të tij.
14. “RDAP (Registration Data Access Protocol)” – protokoll standard për akses të kontrolluar dhe të strukturuar në të dhënat e regjistrimit të emrave të domain-eve.
15. “Regjistri” – sistemi dhe infrastruktura teknike e administruar nga AKEP për regjistrimin dhe menaxhimin e emrave të domain-eve.
16. “Regjistruesi” – i referohet personave juridikë të akredituar nga AKEP-i, të cilët, në kuadër të një marrëveshjeje regjistrimi të lidhur me AKEP-in, ofrojnë shërbime regjistrimi për emra domain-esh në zonën “.al” dhe nën domain-et përkatëse.
17. “Server DNS (Name Server)” – server që përdoret për publikimin dhe menaxhimin e emrave të domain-eve në DNS.
18. “Të dhëna të regjistrimit” – të dhënat që lidhen me identifikimin, kontaktimin dhe administrimin e një emri domain-i.

19. “Të drejta të mëparshme” – të drejtat e njohura nga legjislacioni në fuqi, përfshirë markat tregtare, emrat tregtarë dhe të drejta të tjera të ngjashme.
20. “Transferim” – kalimi i të drejtës së përdorimit të një emri domain-i nga një zotërues tek një tjetër.
21. “Veprime administrative” – veprimet që lidhen me regjistrimin, përditësimin, transferimin, pezullimin, bllokimin dhe fshirjen e një emri domain-i.
22. “Zotëruesi” – çdo individ, subjekt person fizik që ushtron aktivitet tregtar, subjekt juridik publikë ose privat, shqiptar ose i huaj që ka regjistruar një emri domain-i.

## **Neni 2**

### **Qëllimi**

Kjo rregullore synon të krijojë një kuadër të qartë, të drejtë dhe të sigurt për menaxhimin e domain-eve “.al”, duke përcaktuar:

- a. rregullat për regjistrimin dhe administrimin e emrave të domain-eve nën “.al” dhe nën-domainet përkatëse (.gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al, .net.al);
- b. garantimin që regjistrimi dhe përdorimi i domain-eve të kryhet në interes të publikut;
- c. respektimin e parimeve të mosdiskriminimit dhe transparencës në procesin e regjistrimit;
- d. mbrojtjen e lirisë së komunikimit dhe të sipërmarrjes në hapësirën e internetit;
- e. respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale dhe të të drejtave të palëve të treta;
- f. përcaktimin e procedurave për regjistrimin, përdorimin, administrimin dhe zgjidhjen e ankesave apo mosmarrëveshjeve që lidhen me domain-et.

## **Neni 3**

### **Zbatueshmëria**

1. Dispozitat e kësaj rregulloreje konsiderohen drejtpërsëdrejti të zbatueshme:

- a. për të gjithë emrat e rinj të domain-eve;
- b. për emrat ekzistues të domain-eve, në rast se paraqitet një kërkesë për veprim administrativ ose në rast rinovimi të tyre.

2. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga legjislacioni ose nga një vendim i Këshillit Drejtues, rregullat e reja nuk kanë efekt prapaveprues.

## **Neni 4**

### **Kushtet dhe kërkesat e përgjithshme**

1. AKEP, gjatë procesit të regjistrimit, vepron në mirëbesim mbi bazën e parimit të vetëdeklarimit, duke prezumuar saktësinë, vërtetësinë dhe ligjshmërinë e të dhënave të paraqitura nga aplikuesi. AKEP ruan të drejtën për të verifikuar këto të dhëna në çdo kohë, në rast dyshimi, ankimi ose kontrolli administrativ.

2. Aplikuesi mban përgjegjësi ligjore, në bazë të legjislacionit në fuqi, për vërtetësinë, saktësinë dhe autenticitetin e të gjitha të dhënave të paraqitura në zbatim të kësaj Rregulloreje.
3. Nëpërmjet procesit të aplikimit për regjistrim të emrit të domain-it, aplikuesi:
  - a. konfirmon shprehimisht pranimin e kushteve të kësaj Rregulloreje;
  - b. merr përsipër të respektojë të gjitha detyrimet që rrjedhin prej saj;
  - c. deklaron se nuk cënon të drejtat e palëve të treta, duke përfshirë ato të parashikuara nga legjislacioni për konkurrencën, të drejtën e autorit, pronësinë intelektuale dhe trashëgiminë kulturore.
4. Konfirmimi i marrë në rrugë elektronike gjatë procesit të aplikimit, ka vlerë juridike të barasvlershme me një deklaratë të shkruar, në përputhje me legjislacionin në fuqi për dokumentin elektronik dhe nënshkrimin elektronik.
5. Regjistruerit e akredituar ruajnë evidencën elektronike të pranimit të kushteve nga aplikuesi, duke përfshirë kohën dhe datën e konfirmimit, e cila mund të përdoret si provë në rast mosmarrëveshjeje.
6. Aplikuesi mban përgjegjësi për çdo cënim të të drejtave të palëve të treta që mund të rrjedhë nga regjistrimi ose përdorimi i emrit të domain-it, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

## **KAPITULLI II**

### **RREGULLAT QË LIDHEN ME EMRAT E DOMAIN-EVE**

#### **Neni 5**

#### **Rregullat Sintaksore**

1. Emrat e domain-eve përbëhen nga karaktere alfanumerike të alfabetit latin (a-z), shifrat (0-9) dhe shenja lidhëse “-”.
2. Emrat e domain-eve “ndërkombëtarë” ose “të ndërkombëtarizuar” (IDN) përbëhen nga karaktere të ndryshme nga ato ASCII. Karakteret alfanumerike të mëposhtme lejohen për përdorim në emrat e domain-eve IDN.: a, à, á, â, ã, ä, å, æ, b, c, ç, d, e, è, é, ê, ë, f, g, h, i, ì, í, î, ï, j, k, l, m, n, ñ, o, ò, ó, ô, õ, ö, œ, p, q, r, s, t, u, ù, ú, û, ü, v, ë, x, y, ý, ÿ, z, ß, 0–9, and hyphen.
3. Regjistrimi i emrave të domain-eve të ndërkombëtarizuara (IDN), sipas pikës 2 të këtij neni, do mundësohet pas sigurimit të infrastrukturës teknike nga AKEP, për implementimin e saj. Realizimi i pikës 3, do t’u njoftohet palëve brenda një afati të arsyeshëm.
4. Nga pikpamja sintaksore nuk mund të regjistrohen emrat e domain-eve të mëposhtëm kur:
  - a) Emrat përbëhen nga një karakter;
  - b) Emrat fillojnë ose mbarojnë me minus “-”;
  - c) Emrat përbëhen nga më shumë se 63 karaktere;
  - d) Emrat fillojnë me dy karaktere alfanumerike të çfarëdoshme të pasuara nga dy minuse (formati “xy--”).

## **Neni 6**

### **Kategoritë e domain-eve**

1. Zonat e emrave të kontrolluara nga AKEP janë emrat nën “.al” dhe nëndomain-et “.com.al, .org.al, .net.al, .gov.al, .edu.al dhe .mil.al”
2. Regjistrimi i nëndomain-eve “.gov.al” dhe “.mil.al” kryhet vetëm nga AKEP, sipas kushteve të veçanta të përcaktuara në Aneksin 1 të kësaj Rregullore.
3. Regjistrimi i domaineve “.al” dhe nëndomain-eve “.com.al, .net.al, .org.al dhe .edu.al” e bëjnë vetëm Regjistruesit e akredituar nga AKEP.
4. Institucionet publike qendrore dhe vendore, institucionet e pavarura si dhe strukturat e mbrojtjes kanë të drejtë të regjistrojnë domain-e në zonën “.al”, pranë AKEP ose regjistruesve të akredituar, në përputhje me përcaktimet e kësaj rregulloreje.
5. Kushti për regjistrimin e emrave të domain-eve nën “.edu.al”, të rezervuar për institucionet e sistemit arsimor, shkencor dhe edukativ të Republikës së Shqipërisë, është që emri i nëndomain-it, të përputhet plotësisht ose pjesërisht me emrin e institucionit ose projektit që ata ndërmarrin. Institucionet arsimore, shkencore dhe edukative jo publike duhet të depozitojnë dhe një kopje të licencës së lëshuar sipas legjislacionit në fuqi për ushtrimin e aktivitetit. Kërkesa duhet të shoqërohet me dokumentacion mbështetës.
6. Zotëruesit gëzojnë të drejtën mbi emrin e regjistruar të domain-it, gjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së tij, në përputhje me kushtet dhe termat e Rregullores dhe nuk krijon të drejta të tjera përtej atyre të parashikuara në të.
7. Emri i domain-it ka një periudhë vlefshmërie 1 (një) vit deri në 10 (dhjetë) vjet, duke filluar nga data e regjistrimit të tij.

## **Neni 7**

### **Të drejtat e emrit të domain**

1. E drejta për të zotëruar një ose disa emra domain-esh nën administrimin e AKEP, sipas kësaj Rregulloreje jepet si më poshtë:
  - a. për zonën “.al” dhe nëndomain-et “.com.al, .org.al dhe .net.al”, janë personat juridikë publikë dhe privatë, personat fizikë që ushtrojnë aktivitetet tregtar, si dhe individët.
  - b. për nëndomain “.gov.al” dhe të gjitha versionet e saj IDN janë të gjitha institucionet e qeverisjes vendore dhe lokale.
  - c. për nëndomain “.mil.al” dhe të gjitha versionet e saj IDN janë strukturat në përbërje të sistemit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.
  - d. për nëndomain “.edu.al” janë institucionet (persona juridikë publikë dhe privatë) të sistemit arsimor, shkencor dhe edukativ të Republikës së Shqipërisë.

## Neni 8

### Mbrojtja e të drejtave të mëparshme

1. Regjistrimi i emrin të domain-it sipas kësaj Rregulloreje do të bëhet në bazë të parimit “kush aplikon i pari shërbehet i pari” (*first come – first served*).
2. Regjistri dhe regjistruesit nuk kryejnë verifikim paraprak mbi të drejtat e mëparshme të zotëruara mbi emrin e domain-it.
3. Për qëllimet e kësaj Rregulloreje, “të drejtat e mëparshme” përfshijnë, por nuk kufizohen në:
  - a. të drejta që lidhen me markat tregtare të regjistruara në nivel kombëtar dhe/ose ndërkombëtar;
  - b. të drejta që lidhen me emra të personit juridikë ose personit fizikë (individë), të regjistruar sipas legjislacionit në fuqi
  - c. çdo të drejtë tjetër e njohur nga legjislacioni në fuqi
4. Zotëruesi konsiderohet se ka interes legjitim kur përdor ose përgatitet të përdorë emrin në mënyrë të ligjshme përpara njoftimit të mosmarrëveshjes, njihet gjerësisht me të, ose e përdor për qëllime të ligjshme jo-mashtruese.
5. Një emër domain konsiderohet regjistrim abuziv nëse është identik ose i ngjashëm në mënyrë që krijon konfuzion me një të drejtë të mëparshme dhe është regjistruar ose përdoret pa interes legjitim ose jo në mirëbesim.
6. Regjistrimi ose përdorimi jo në mirëbesim përfshin, ndër të tjera, rastet kur emri regjistrohet për përfitim financiar, për të penguar një të drejtë, për të dëmtuar një konkurrent, ose për të mashtruar përdoruesit.
7. Çdo palë që pretendon një të drejtë të mëparshme, ka të drejtë të iniciojë procedurë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes lidhur me një emër domaini sipas përcaktimeve të Kapitullit 7, të kësaj Rregulloreje
8. Në rast se konstatohet regjistrim abuziv, AKEP mund të vendosë:
  - a. fshirjen e emrit të domain-it;
  - b. transferimin e emrit të domain-it tek pala që zotëron të drejtën.

Vendimet janë detyruese për regjistrin dhe regjistruesit.

9. Përgjegjësia për respektimin e të drejtave të palëve të treta bie mbi zotëruesin e domain-it. Regjistri dhe regjistruesit nuk mbajnë përgjegjësi për konfliktet që lidhen me të drejtat e mëparshme mbi emrat e domain-eve.

## **Neni 9**

### **Emrat e ndaluar dhe të rezervuar**

1. AKEP harton dhe mban të përditësuar një listë të emrave të ndaluar të domain-eve të cilët për shkak të specifikës/natyres së tyre, nuk mund të regjistrohen si emra domain-esh.
2. AKEP harton dhe mban të përditësuar një listë të emrave të rezervuar të domain-eve për të cilët regjistrimi i nënshtrohet shqyrtimit dhe miratimit paraprak nga ana e AKEP.
3. Listat e emrave të ndaluar dhe të rezervuar bazohen në parimet e:
  - a. mbrojtjes së interesit publik;
  - b. respektimit të rendit juridik;
  - c. parandalimit të abuzimit dhe mashtrimit;
  - d. mbrojtjes së besueshmërisë së hapësirës “.al”.

Listat nuk janë shteruese dhe përditësohen nga AKEP në mënyrë të vazhdueshme.

4. Emrat e “ndaluar” përfshijnë por nuk kufizohen në:
  - a. emra që bien në kundërshtim me rendin publik ose moralin publik;
  - b. emra me përmbajtje fyese, diskriminuese, raciste ose nxitëse të urrejtjes;
  - c. emra që lidhen me veprimtari të paligjshme, përfshirë krimin, mashtrimin ose terrorizmin;
  - d. emra që krijojnë konfuzion me institucione shtetërore pa autorizim;
  - e. emra që përbëjnë rrezik për sigurinë kombëtare;
  - f. emra që bien në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

AKEP ka të drejtë të refuzojë çdo emër domain-i që, edhe pse në mungesë të listimit të drejtpërdrejtë, bie në kundërshtim me këto parime.

5. Emrat e rezervuar përfshijnë, por nuk kufizohen në:
  - a. emra që lidhen me institucione shtetërore, organe publike ose funksione publike;
  - b. emra gjeografikë (qytete, rajone, territore) dhe ndarjeve administrative;
  - c. emra me rëndësi publike, historike ose kulturore;
  - d. emra që lidhen me infrastrukturën e internetit ose funksione teknike (p.sh. al, nic, ns, dns, www, web, whois);
  - e. emra që AKEP i konsideron të ndjeshëm për interesin publik.

Regjistrimi i këtyre emrave kryhet vetëm pas miratimit nga AKEP.

6. Listat e emrave të ndaluar dhe të rezervuar dhe parimet mbi të cilat ato janë krijuar publikohen në faqen e AKEP.
7. Listat miratohen dhe përditësohen nga AKEP sipas procedurave administrative të brendshme. Çdo ndryshim publikohet dhe u njoftohet regjistruesve së bashku me datën e fundit të miratimit.
8. Konsiderohet detyrimi i aplikantit të njihet me këto lista dhe me parimet mbi të cilat ato janë ngritur para se të fillojë procesin e regjistrimit të një emri domaini.

9. Në rast se një emër domaini i regjistruar përfshihet më pas në listën e emrave të ndaluar ose të rezervuar, AKEP njofton zotëruesin dhe mund të marrë masa proporcionale, duke respektuar parimin e sigurisë juridike dhe të drejtat e fituara të zotëruesit.

10. Aplikuesi, të cilit i refuzohet regjistrimi i emrit të domain-it të kërkuar apo i fshihet domain-i, për shkak të përfshirjes së tij në listën e emrave të ndaluar apo të rezervuar, ka të drejtën e ankimit pranë AKEP sipas afateve dhe përcaktimeve të Kapitullit 7. Kërkesa, detyrimisht duhet të jetë e shoqëruar me arsyetimet përkatëse.

## **Neni 10**

### **Zgjedhja e emrit të domain-it**

1. Aplikuesi ka të drejtë të zgjedhë emrin e domain-it, me përjashtim të rasteve kur ai bie në kundërshtim me këtë rregullore. Aplikuesi mban përgjegjësi për këtë zgjedhje.

2. Zgjedhja e emrit të domain-it i nga aplikuesi duhet të përmbushë kushtet e parashikuara në këtë Rregullore. Konkretisht:

- a. të përmbushë rregullat sintaksore;
- b. të mos jetë i ndaluar ose i rezervuar dhe të mos bjere ndesh me parimet mbi të cilat ato janë ndertuar;
- c. të mos cenojë të drejtat e palëve të treta;
- d. të mos jetë i paligjshëm ose mashtrues.

3. Mundësia e kërkimit në kohë reale për domain nën .al, është e disponueshme dhe funksionale, në faqen web të AKEP dhe Regjistruesve, të paktën në gjuhën shqipe dhe ky seksion përmban linkun e Rregullores së AKEP për domainet .al, listën e emrave të ndaluar dhe rezervuar si dhe çdo informacion të kërkuar nga kjo rregullore.

## **KAPITULLI III**

### **REGJISTRI**

## **Neni 11**

### **Roli i Regjistrimit**

1. AKEP, ushtron rolin e regjistrimit për të gjithë emrat e domain-eve nën “.al” dhe nëndomain-et përkatëse “.com.al, .org.al, .net.al .edu.al, .gov.al dhe .mil.al”.

2. Emrat e domain-eve regjistrohen përmes regjistruesve të akredituar dhe kërkesat përkatëse nuk paraqiten drejtpërdrejtë në AKEP, përveç rasteve të parashikuara në këtë rregullore.

3 Emrat e domain-eve “.gov.al” dhe “.mil.al” regjistrohen vetëm nga AKEP, sipas kushteve të përcaktuara në Aneksin 1.

4. AKEP, në cilësinë e regjistrisë, nuk ushtron aktivitet si regjistrues për domain-et për të cilat ka akredituar subjekte të tjera.

5. AKEP vepron mbi bazën e parimeve të transparencës, mosdiskriminimit dhe interesit publik.

6. AKEP nuk kryen verifikim paraprak të zotërimit të drejtave nga palë të treta ose të ligjshmërisë së kërkesave, me përjashtim të rasteve të përcaktuara shprehimisht në këtë rregullore.

7. AKEP mund të vendosë në dispozicion mekanizma për raportimin e emrave të domain-eve që mund të jenë në kundërshtim me ligjin ose këtë rregullore.

8. Raportimet bëhen nën përgjegjësinë e vetme të autorit të tyre dhe duhet të shoqërohen me arsyetimin dhe dokumentacionin mbështetës.

9. Paraqitja e një raportimi nuk përbën automatikisht procedurë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

10. AKEP përcakton dhe përditëson specifikimet teknike dhe mënyrat e aksesit në sistemin e regjistrisë, të cilat u komunikohen regjistruesve.

11. AKEP garanton sigurinë dhe integritetin e regjistrisë dhe mund të kërkojë nga regjistruesit zbatimin e masave përkatëse.

12. AKEP mban dhe publikon në faqen e tij zyrtare Regjistrin e Regjistruesve të akredituar, me të dhënat e tyre të kontaktit, me qëllim garantimin e transparencës dhe informimit publik. Ky regjister do të përmbajë këto të dhëna:

- a. Emrin dhe adresën e regjistruesit;
- b. Numrin e identifikimit të personit të tatueshëm (NIPT);
- c. Faqen web;
- d. Të dhënat (telefon, fax, email) të kontaktit të deklaruara në AKEP;
- e. Numrin dhe datën e lëshimit të Certifikatës nga AKEP,

## **Neni 12**

### **Të dhënat e detyrueshme për regjistrimin e emrit të domain-it**

1. Për regjistrimin e një emri domain-i nën ccTLD “.al”, regjistruesi është i detyruar të mbledhë dhe të paraqesë në sistemin e regjistrisë të dhënat e nevojshme për identifikimin dhe kontaktimin e zotëruesit të domain-it, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Regjistri përmban, në mënyrë të detyrueshme, të paktën këto të dhëna:

- a. emrin e domain-it;
- b. datën e regjistrimit;
- c. datën e përfundimit të vlefshmërisë;

3. Për subjektet juridikë (shoqëri tregtare, institucione, organizata), regjistruesi paraqet:

- a. emrin e subjektit;
- b. numrin e identifikimit (NUIS/NIPT)
- c. adresën postare;
- d. adresën e postës elektronike;
- e. numrin e telefonit/celular të pikës së kontaktit administrativ.

4. Për individët, regjistruesi paraqet:

- a. emrin dhe mbiemrin;
- b. numrin personal të identifikimit;
- c. adresën postare;
- d. adresën e postës elektronike;
- e. numrin e telefonit/celular;
- f. të dhënat e kontaktit administrativ, në rast se janë të ndryshme nga ato të zotëruesit.

5. Regjistrimi i emrit të domain-it nuk kryhet nëse ka mangësi në të dhënat e detyrueshme ose nuk përmbushin kërkesat e përcaktuara në këtë nen.

### **Neni 13**

#### **Kompetencat e Regjistrimit mbi të dhënat e regjistrimit**

1. AKEP mund të iniciojë në çdo kohë, një proces verifikimi për saktësinë e të dhënave, kontaktueshmërinë e zotëruesit/kontaktit administrativ dhe në përgjithësi për respektimin e kësaj rregulloreje.

2. Verifikimi mund të iniciohet edhe pas një raportimi/ankese nga palë të treta në AKEP.

3. Në rast të konstatimit të shkeljeve të kësaj rregulloreje, AKEP fillon një procedurë korrigjimi dhe njofton regjistruesin dhe zotëruesin. Sipas rastit, AKEP mund të vendosë:

- a. pezullimin e përkohshëm të veprimeve;
- b. bllokimin e emrit të domain-it;
- c. fshirjen e tij.

4. AKEP, nuk mban përgjegjësi për dëmin që mund t'i shkaktohet zotëruesit të një emri domain, si rezultat i një veprimi pezullimi, bllokimi apo fshirje të një emri domain, për shkaqet e parashikuara në këtë rregullore.

5. Procedura e filluar nga AKEP, mund të ndërpritet në çdo kohë nëse parregullsitë e konstatuara dhe të njoftuara, korrigjohen në kohë.

## **KAPITULLI IV REGJISTRUESIT**

### **Neni 14 Roli i Regjistruesve**

1. Kërkesat për veprime mbi emrat e domain-eve paraqiten përmes regjistruesve të akredituar, të cilët veprojnë si ndërmjetës ndërmjet aplikuesit dhe/ose zotëruesit dhe AKEP.
2. Individët, subjektet persona fizikë dhe juridikë që dëshirojnë të regjistrojnë ose të kryejnë veprime mbi një emër domain-i duhet të zgjedhin një regjistrues nga lista e regjistruesve të akredituar dhe publikuar nga AKEP në faqen zyrtare të tij.
3. Për çdo kërkesë, regjistruesi i paraqet AKEP, informacionin e nevojshëm për përpunimin e saj.

### **Neni 15 Akreditimi i Regjistruesve**

1. Çdo person juridikë që do të veprojë si Regjistrues për emra domain-esh që përfshihen në listën e domaineve nën administrimin e AKEP-it, duhet të akreditohet nga AKEP.
2. Qëllimi i akreditimit është të sigurojë që regjistruesi përmbush kërkesat ligjore dhe teknike për ushtrimin e aktivitetit.
3. Akreditimi bazohet në informacionin e paraqitur nga aplikuesi dhe nuk përbën garanci për cilësinë e shërbimeve të regjistruesit.
4. Kushtet dhe procedurat e akreditimit përcaktohen në Aneksin 2, të kësaj rregulloreje.

### **Neni 16 Përgjegjësitë e Regjistruesve**

1. Regjistruesi mban përgjegjësi të plotë ndaj AKEP dhe ndaj zotëruesve të domain-eve për veprimtarinë e tij si regjistrues i akredituar. Në veçanti, regjistruesi është përgjegjës për:
  - a. marrëdhënien kontraktuale me zotëruesit/klientët e tij;
  - b. çdo pretendim të palëve të treta në lidhje me procesin e regjistrimit të emrit të domain.
  - c. përpunimin korrekt dhe të saktë të kërkesave për regjistrim dhe administrim të emrave të domain-eve;
  - d. mbrojtjen e të dhënave personale, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Regjistruesi është përgjegjës për saktësinë e të dhënave dhe veprimet e kryera në emër të aplikuesve dhe zotëruesve.

3. Regjistruesi është i detyruar të ketë në fuqi një marrëveshje akreditimi të nënshkruar me AKEP-in.
  4. Regjistruesi është i detyruar të respektojë kërkesat teknike dhe procedurale të përcaktuara nga AKEP për komunikimin me regjistrin.
  6. Në rast të mbylljes/ndërprerjes të aktivitetit, regjistruesi bashkëpunon me AKEP për transferimin e domain-eve dhe garantimin e vazhdimësisë së shërbimit.
  7. AKEP ka të drejtë të auditojë veprimtarinë e regjistruesit për të verifikuar përputhshmërinë me këtë rregullore.
  8. AKEP, sipas rastit, ndërmerr masa administrative ndaj regjistruesve në rast shkeljeje të detyrimeve që rrjedhin nga kjo rregullore, duke përfshirë:
    - a. paralajmërim;
    - b. pezullim të përkohshëm të akreditimit, në rast moskorrigjimi të mangësive të konstatuara nga AKEP.
    - c. revokim të akreditimit në rast shkeljesh të përsëritura ose të rënda
- Masat e parashikuara në këtë nen zbatohen në mënyrë proporcionale, duke marrë parasysh natyrën, shpeshtësinë dhe pasojat e shkeljes.
9. AKEP, njofton regjistruesin dhe kur është e nevojshme, zotëruesit e domain-eve përkatës.

#### **Neni 17**

#### **Saktësia e të dhënave**

1. Regjistruesi është përgjegjës për saktësinë dhe plotësinë e të dhënave të paraqitura në regjistër në emër të aplikuesve dhe zotëruesve të emrave të domain-eve.
2. Regjistruesi është i detyruar të verifikojë paraprakisht të dhënat e detyrueshme përpara paraqitjes së tyre në sistemin e regjistrit qendror të AKEP.
3. Në rast se AKEP konstaton se të dhënat e paraqitura nga regjistruesi kanë mangësi, atëherë njofton regjistruesin dhe kërkon korrigjimin e të dhënave brenda një afati të arsyeshëm dhe sipas rastit merr masat e parashikuara në nenin 16 të kësaj rregulloreje.

## **KAPITULLI V**

### **RREGULLAT PËR ZOTËRUESIN E DOMAIN-IT**

## **Neni 18**

### **Zotëruesi i një emri domain-i në zonën “.al”**

1. Zotëruesi i një emri domain-i është çdo individ, subjekt person fizik që ushtron aktivitet tregtar, subjekt juridik publikë ose privat, shqiptar ose i huaj, në emër të të cilit është regjistruar emri i domain-it.
2. Numri i domain-eve që mund të posedojë në përdorim një subjekt sipas kësaj Rregulloreje është i pakufizuar.
3. Zotëruesi dhe kontakti administrativ duhet të jenë të identifikueshëm dhe të arritshëm në çdo kohë.
4. Zotëruesi është i detyruar të deklarojë dhe të mirëmbajë të dhëna kontakti të sakta dhe funksionale, përfshirë një numër telefoni dhe një adresë elektronike aktive.

## **Neni 19**

### **Kontakti administrativ dhe kontakti teknik**

1. Në momentin e regjistrimit të emrit të domain-it, zotëruesi përcakton një kontakt administrativ.
2. Kontakti administrativ mund të jetë vetë zotëruesi ose një palë e tretë e autorizuar prej tij dhe ky i fundit nuk fiton asnjë të drejtë mbi emrin e domain-it.
3. Kontakti administrativ duhet të jetë i identifikueshëm dhe i arritshëm, pavarësisht nëse zotëruesi i emrit të domain-it është me vendbanim ose qendër në Shqipëri apo në një shtet të huaj.
4. Zotëruesi mund të përcaktojë një kontakt teknik për administrimin teknik të emrit të domain-it. Kontakti teknik mund të jetë edhe regjistruesi ose.
5. Zotëruesi është i detyruar të mbajë të përditësuara të dhënat e kontakteve të përcaktuara sipas këtij neni.
6. AKEP, ose regjistruesi mund të kontaktojnë zotëruesin ose kontaktet e njoftuara prej tij, për çdo çështje që lidhet me administrimin e emrit të domain-it.
7. AKEP, nuk mban përgjegjësi për marrëdhëniet ndërmjet zotëruesit dhe kontakteve të përcaktuara prej tij.

## **Neni 20**

### **Përgjegjësitë e zotëruesit të emrit të domain-it**

1. Regjistrimi dhe rinovimi i emrit të domain-it kryhet nën përgjegjësinë e zotëruesit.

2. Përdorimi i emrit të domain-it është përgjegjësi ekskluzive e zotëruesit.
3. Zotëruesi është i detyruar të respektojë këtë rregullore dhe kërkesat e AKEP dhe regjistruarit.
4. Zotëruesi është përgjegjës për saktësinë dhe përditësimin e të dhënave të paraqitura.
5. Zotëruesi përditëson të dhënat brenda 3 (tre) muajve kalendarike nga momenti i ndryshimit, me ndërmjetësimin e Regjistruarit.
6. Zotëruesi mban përgjegjësi për çdo pretendim të palëve të treta që lidhet me përdorimin e emrit të domain-it, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

## **KAPITULLI VI**

### **VEPRIMET ME EMRAT E DOMAIN-EVE**

#### **Neni 21**

#### **Regjistrimi i nje emri domain**

1. Kërkesat për regjistrimin e emrave të domain-eve paraqiten nga regjistruarit e akredituar përmes sistemeve elektronike të AKEP.
2. Pas marrjes së kërkesës, sistemi i regjistrimit kryen kontrollet automatike si më poshtë:
  - a. disponueshmërinë e emrit të domain-it;
  - b. përfshirjen në listën e emrave të ndaluar, ose të rezervuar;
  - c. plotësinë e të dhënave të detyrueshme.
3. Në rast se përmbushen kriteret e përcaktuara në këtë nen regjistrimi kryhet automatikisht, në të kundërt kërkesa refuzohet.
4. Pas regjistrimit fillestar, të gjitha të dhënat e lidhura me emrin e domain-it mund të përditësohen, me përjashtim të vetë emrit të domain-it, i cili nuk mund të ndryshohet.

#### **Neni 22**

#### **Pezullimi i një emri domain**

1. Një emër domain mund të jetë subjekt i pezullimit në rastet e mëposhtme:
  - a. në bazë të një vendimi gjyqësor mbështetur nga një ekzekutim i përkohshëm ose me fuqinë e vendimit përfundimtar,

- b. në bazë të një vendimi të gjykatës së shtetit të huaj atëherë kur është njohur si i ekzekutueshëm në përputhje me dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurave Civile.
- c. në rastin e procedurës administrative, të filluar nga AKEP por jo më shumë se 30 (tridhjetë) ditë.

2. Pezullimi ndalon kryerjen e veprimeve mbi emrin e domain-it.

3. Pezullimi nuk ndikon në funksionimin teknik të domain-it.

4. Për rastet sipas pikave a dhe b, të pikës 1 të këtij neni, pezullimi zgjat deri në zgjidhjen e shkakut që e ka diktuar.

### **Neni 23**

#### **Blokimi i një emri domaini**

1. Një emër domain mund të bllokohet në rastet e mëposhtme:

- a. në bazë të një vendimi gjyqësor mbështetur nga një ekzekutim i përkohshëm ose me fuqinë e vendimit përfundimtar;
- b. në bazë të një vendimi të gjykatës së shtetit të huaj atëherë kur është njohur si i ekzekutueshëm në përputhje me dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurave Civile;
- c. në rastin e procedurës administrative, të filluar nga AKEP por jo më shumë se 30 (tridhjetë) ditë;
- d. me kërkesë të arsyetuar të autoriteteve kompetente;
- e. në rastet e domain-eve pa regjistruar.

3. Në rastin e bllokimit të një emri domain, sipas pikës “d”, të pikës 1 të këtij neni, ndërhyrja në infrastrukturën e domain-eve apo në sistemin DNS, ndërmerret nga AKEP, vetëm nëse ekziston një kërkesë e bazuar në ligjin sektorial në fuqi nga autoritetet kompetente, e justifikuar nga një rrezik i drejtpërdrejtë në interesin publik, sikurse mund të jetë siguria kombëtare, përmbajtje e paligjshme apo e dëmshme që përfshin të mitur, nxitjen e urrejtjes, dhunës, mashtrim financiar dhe nëse autoritetet kanë kontaktuar më parë me zotëruesin e domain për këtë qëllim.

2. Në rastin e bllokimit të një emri domain anulohen të gjitha veprimet në proces trajtimi nga AKEP dhe nuk mund të paraqiten kërkesa të reja për veprime mbi emrin e domain-it.

3. Për rastet e përcaktuara në pikat a, b, d dhe e, të pikës 1 të këtij neni, bllokimi zgjat deri në zgjidhjen e shkakut që e ka diktuar.

### **Neni 24**

#### **Fshirja e një emri domain**

1. Një emër domain mund të fshihet në rastet e mëposhtme:

- a. me kërkesë të zotëruesit;

- b. pas përfundimit të afatit të vlefshmërisë dhe mos rinovimit të tij;
- c. në bazë të një vendimi gjyqësor mbështetur nga një ekzekutim i përkohshëm ose me fuqinë e vendimit përfundimtar;
- d. në bazë të një vendimi të gjykatës së shtetit të huaj, kur është njohur si i ekzekutueshëm në përputhje me dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurave Civile;
- e. në rastin e procedurës administrative, të filluar nga AKEP sipas nenit 13 të kësaj rregulloreje;
- f. me kërkesë të autoriteteve kompetente në përputhje me ligjin;

2. Pas përfundimit të afatit të vlefshmërisë, emri i domain-it hyn në një periudhë tolerance (*grace period*) prej 30 (tridhjetë) ditësh kalendarike, gjatë së cilës:

- a. zotëruesi ruan të drejtën për të rinovuar emrin e domain-it përmes regjistruesit përkatës;
- b. emri i domain-it, bëhet i disponueshëm për regjistrim nga palë të treta.

3. Nëse rinovimi kryhet brenda periudhës së tolerancës prej 30 ditësh, afati i rinovimit fillon nga momenti i përfundimit të vlefshmërisë së emrit të domain-it, pa u llogaritur periudha tranzitore prej 30 ditësh. Në rast se në përfundim të afatit të periudhës tranzitore prej 30 ditësh, rinovimi nuk është kryer, emri i domain-it, bëhet i disponueshëm për regjistrim nga çdo subjekt tjetër.

4. Në rastet kur fshirja e një emri domain-i, ndodh sepse domaini bëhet pjesë në listat e domaineve të ndaluar ose të rezervuar pas përditësimit të tyre, afati për mbylljen e domainit është 3 (tre) muaj nga përfshirja e këtij domani-i në këto lista. Kjo kohë është e nevojshme për t'i dhënë mundësi zotëruesit për të zgjedhur një emër tjetër domain-i dhe sigurimin e një tranzicioni normal.

5. Pas përfundimit të procedurës së fshirjes, emri i domain-it, sipas rastit, bëhet i disponueshëm për regjistrim ose shtohet në listën e emrave të ndaluar ose të rezervuar.

## **Neni 25**

### **Transferimi vullnetar**

1. Emri i domain-it mund të transferohet nga një zotërues tek një tjetër me pëlqimin e palëve.
2. Transferimi nuk lejohet brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga regjistrimi ose transferimi i fundit.
3. Transferimi do të refuzohet nëse të dhënat nuk janë të plota, të sakta dhe nëse ekzistojnë detyrime financiare të pashlyera.
4. Në rastin kur zotëruesi është subjekt i procedurave të falimentimit, likuidimit ose procedurave të tjera kolektive që lidhen me paaftësinë e tij paguese, transferimi kryhet nga administratori ligjor.

## **Neni 26**

### **Transferimi i detyrueshëm**

1. Regjistri mund të realizojë transferimin e detyrueshëm të një emri domain nga një zotërues tek një tjetër në rastet e mëposhtme:

- a. në bazë të një vendimi gjyqësor mbështetur nga një ekzekutim i përkohshëm ose me fuqinë e vendimit përfundimtar;
  - b. në bazë të një vendimi të gjykatës së shtetit të huaj, kur është njohur si i ekzekutueshëm në përputhje me dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurave Civile;
  - c. në rastin e procedurës administrative, të filluar nga AKEP sipas nenit 13 të kësaj rregulloreje;
  - d. në rast të një riorganizimi juridik të zotëruesit;
2. Zotëruesi i ri është i detyruar të përmbushë të gjitha kërkesat për identifikim dhe pranueshmëri të përcaktuara në këtë Rregullore.
  3. Kostot teknike dhe administrative që lidhen me transferimin e detyrueshëm përballohen nga zotëruesi i ri, si dhe është përgjegjës për të gjitha detyrimet e pashlyera nga zotëruesi i mëparshëm.
  4. Për të bërë të mundur kalimin e emrit të domain-it tek zotëruesi i ri, duhet që ky i fundit të paraqesë kërkesën për transferim brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga marrja e njoftimit për titullin ekzekutiv.

### **Neni 27**

#### **Ndryshimi i regjistruesit**

1. Zotëruesi i emrit të domain-it ka të drejtë të ndryshojë regjistruesin, në përputhje me detyrimet kontraktore ndërmjet palëve.
2. Ndryshimi i regjistruesit do të refuzohet nga Regjistri nëse të dhënat nuk janë të plota ose të sakta.
3. Ndryshimi i regjistruesit nuk ndikon në të drejtën e zotërimit të emrit të domain-it.
4. Ndryshimi i regjistruesit kryhet kundrejt pagesës prej 1 (një) krediti nga regjistruesi pritës dhe shoqërohet me shtyrjen e afatit të domain-it me 1 (një) vit, nga data e përfundimit të vlefshmërisë së tij.
5. Regjistruesi nuk mund të ndryshohet pa kaluar 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga regjistrimi fillestar, një transferim i mëparshëm apo ndryshimi i zotëruesit.
6. Në rast revokimi të akreditimit, zotëruesit e emrave të domain-eve të regjistruara përmes Regjistruesit të cilit i është revokuar akreditimi, kanë të drejtë të zgjedhin regjistruesin pranë të cilit do të kryejnë transferojnë domain-et e tyre pranë një Regjistruesi tjetër aktiv dhe të akredituar. Ky transferim do të jetë pa pagesë.

### **Neni 28**

#### **Emrat e domain-it pa regjistrues**

1. Një emër domain konsiderohet pa regjistrues (*orphan domain*) kur regjistruesi nuk është më në gjendje të administrojë emrin e domain-it, përfshirë rastet e:
  - a. tërheqjes së akreditimit të regjistruesit nga AKEP;
  - b. ndërprerjes, falimentimit ose procedurave të tjera të paaftësisë paguese së veprimtarisë së regjistruesit;

2. Në këto raste, zotëruesi i emrit të domain-it duhet të zgjedhë një regjistruer të ri, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e njoftimit.

3. Nëse regjistruerit nuk njofton paraprakisht zotëruesit për këtë situatë, AKEP njofton zotëruesin dhe sipas rastit, kontaktin administrativ për nevojën e ndryshimit të regjistruerit.

## **KAPITULLI VII ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

### **Neni 29**

#### **Rastet e dhe trajtimi i ankesave**

1. Çdo palë e interesuar mund të paraqesë ankesë pranë AKEP për raste që lidhen me:

- a. saktësinë e të dhënave të regjistrimit të një emri domain;
- b. regjistrimin e emrit të domain, në kundërshtim me këtë rregullore;
- c. refuzimin e regjistrimit ose fshirjen e emrit të domain;
- d. mbrojtjen e të drejtave të mëparshme mbi një emër domain;
- e. përdorimin e emrit të domain, në mënyrë të paligjshme në bazë të legjislacionit në fuqi.

3. Ankesa depozitohet me shkrim dhe shoqërohet me dokumentacionin që vërteton pretendimet e palës ankuese.

4. Me marrjen e ankesës, AKEP, i kërkon regjistruerit informacion si dhe të njofton zotëruesin në lidhje me ankesën e depozituar duke kërkuar paraqitjen e shpjegimeve.

5. AKEP, shqyrton ankesat në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje. Përpara se AKEP të shqyrtojë nga ana administrative ankesat e ardhura, ankuesi duhet të kryejë një tarifë administrative, vlera e të cilës do të përcaktohet me vendim të Këshillit Drejtues të AKEP.

6. Afati për shqyrtimin e ankesave në zbatim të kësaj rregulloreje është 60 ditë.

7. Nga shqyrtimi i ankesës, AKEP, sipas rastit mund të përcaktojë:

- a. pezullimin e përkohshëm të veprimeve mbi domain-in, për një periudhë maksimale prej 30 (tridhjetë) ditësh.
- b. bllokimin e emrit të domain-it, për një periudhë maksimale prej 30 (tridhjetë) ditësh;
- c. fshirjen e domain.
- d. rrëzimin e ankesës.

## **Neni 30**

### **Ankimi administrativ dhe vendimmarrja e Këshillit Drejtues**

1. Kundër vendimit të AKEP, bëhet ankim pranë Këshillit Drejtues të AKEP, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të AKEP.
2. Paraqitja e ankimit administrativ, pezullon ekzekutimin e vendimit të AKEP të ankimuar.
3. Me marrjen e ankimit, Kabineti i Kryetarit të KD vë në dijeni Këshillin Drejtues dhe përcjell ankimin sëbashku me praktikën dokumentare shoqëruese, drejtorisë që mbulon çështjet ligjore dhe drejtorisë që mbulon çështjet e domain-eve.
4. Drejtoritë sipas pikës 3 të këtij neni, trajtojnë ankimin duke përpiluar opinionin dhe aktet për shqyrtim në mbledhjen e KD. Afati i shqyrtimit të ankimit është 30 ditë nga data e depozitimit të ankimit dhe procedura zbatohet në përputhje me përcaktimet e Kodit të Procedurave Administrative. Në përfundim të shqyrtimit të ankimit, Këshilli Drejtues nxjerr një vendim përfundimtar i cili i dërgohet subjektit dhe strukturave të AKEP për ekzekutimin e tij.
5. Kundër vendimit të Këshillit Drejtues subjekti ka të drejtë të paraqesë ankim në Gjykatë në përputhje me legjislacionin në fuqi, brenda 45 ditëve nga data e marrjes së vendimit.

## **KAPITULLI VIII**

### **TË DHËNAT PERSONALE DHE KONFIDENCIALITETI**

## **Neni 31**

### **Konfidencialiteti dhe të dhënat personale**

1. AKEP, në çdo rast garanton respektimin e të drejtës së zotëruesit të një emri domain, për mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësinë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Të dhënat e zotëruesve të një emri domain, që ndodhen në regjistrin elektronik të domain-eve, konsiderohen konfidenciale dhe nuk u jepen palëve të treta, përveç rasteve kur:
  - a. publikohen përmes shërbimit RDAP në përputhje me këtë rregullore;
  - b. kërkohen nga një autoritet kompetent në bazë të legjislacionit në fuqi;
  - c. kërkohet paraqitja e tyre me kërkesë të gjykatës ose një organi alternativ kompetent për zgjidhjen mosmarrëveshjeve.
3. Përpunimi i të dhënave personale në kuadër të administrimit të emrave të domain-eve kryhet për këto qëllime:
  - a. ofrimin e shërbimeve të regjistrimit nga regjistruesi;

- b. administrimin dhe mirëmbajtjen e regjistrit nga AKEP.
4. AKEP dhe regjistruesit janë përgjegjës për respektimin e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe vepronë si kontrollues të të dhënave për përpunimet që kryejnë, secili brenda kompetencave të veta dhe në përputhje me bazën ligjore përkatëse.
  5. Shkëmbimi i të dhënave personale ndërmjet AKEP dhe regjistruesve kryhet vetëm për qëllime të përcaktuara dhe në përputhje me bazën ligjore përkatëse.
  6. Zotëruesit, të dhënat e të cilëve përpunohen, gëzojnë të drejtat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, përfshirë të drejtën e aksesit, korrigjimit dhe kundërshtimit. AKEP dhe regjistruesit sigurojnë që subjektet e të dhënave të kenë mundësi të ushtrojnë të drejtat e tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi.
  7. Të dhënat personale ruhen vetëm për aq kohë sa është e nevojshme për qëllimet për të cilat janë mbledhur dhe në përputhje me kërkesat ligjore.

### **Neni 32** **Shërbimi RDAP**

1. Të dhënat e regjistrimit të emrave të domain-eve nën ccTLD .al publikohen përmes shërbimit RDAP, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe praktikatat ndërkombëtare.
2. AKEP është përgjegjëse për administrimin e bazës së të dhënave të regjistrimit, e cila përmban të gjitha të dhënat e nevojshme për identifikimin dhe administrimin e emrave të domain-eve.
3. Administrimi dhe publikimi i të dhënave përmes RDAP bazohet në parimet e minimizimit të të dhënave, mbrojtjes së të dhënave personale, saktësisë dhe përditësimit të tyre, aksesit të kontrolluar dhe sigurisë së informacionit.
4. Përmes shërbimit RDAP publikohen vetëm të dhëna teknike dhe minimale, në përputhje me kapacitetet teknike të sistemit të regjistrit, si më poshtë:
  - a. emri i domain-it;
  - b. statusi i domain-it;
  - c. datat e regjistrimit, përditësimit dhe përfundimit të vlefshmërisë;
  - d. emri i regjistruesit;
  - e. serverat DNS (nameserver-at);
  - f. të dhëna teknike mbi statusin e domain-it;
  - g. identifikues teknikë ose role funksionale të lidhura me domain-in, pa përfshirë të dhëna personale.
5. Publikimi i çdo të dhëne shtesë varet nga zhvillimi teknik i sistemit dhe përcaktohet nga AKEP në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.
6. Nuk publikohen përmes RDAP të dhëna personale ose të ndjeshme, përfshirë të dhëna identifikuese të zotëruesit, të dhëna kontakti apo çdo informacion tjetër i mbrojtur nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale.

7. AKEP dhe regjistruerit zbatojnë masa teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave nga akses i paautorizuar, humbje apo manipulim. Akseset në të dhënat jo publike regjistrohen dhe ruhen për qëllime auditimi.

8. AKEP nuk mban përgjegjësi për:

- a. probleme teknike që lidhen me aksesin në shërbimin RDAP;
- b. mosfunksionimin e rrjetit të Internetit;
- c. ndërprerje të shërbimit për shkak të forcës madhore;
- d. ndërhyrje të nevojshme për mirëmbajtje teknike;
- e. përdorimin abuziv nga palë të treta të të dhënave të publikuara.

9. Ndalohet përdorimi i të dhënave të RDAP për qëllime marketingu, spam-i ose aktivitete të tjera abuzive, si dhe grumbullimi masiv i tyre pa autorizim. AKEP ka të drejtë të vendosë kufizime teknike dhe procedurale për të parandaluar abuzimin.

10. Zbatimi i shërbimit RDAP bëhet në momentin e përfundimit të implementimit teknik nga AKEP. Deri në atë moment, AKEP mund të përdorë mekanizma ekzistues për publikimin e të dhënave. Data e aktivizimit të shërbimit RDAP publikohet me njoftim zyrtar.

## **KAPITULLI IX DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT**

### **Neni 33**

#### **Dispozita kalimtare**

1. Deri në momentin e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, AKEP:

- a. do të implementojë në sistemin teknik, përcaktimet e reja të kësaj rregulloreje;
- b. do të miratojë vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP për transferimin e domain-eve “.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al, nga AKEP tek një regjistruer tjetër i akredituar dhe realizimin e procedurave të transferimit të tyre.
- c. do të miratojë vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP, për përcaktimin e vlerave dhe afateve lidhur me regjistrimin dhe rinovimin e emrave të domain-eve.

### **Neni 34**

#### **Shfuqizime**

Rregullore nr. 2 datë 21.02.2008, “Për regjistrimin dhe administrimin e emrave të domain-eve nën .al dhe nën domain-et .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al”, e ndryshuar, shfuqizohet me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje.

**Neni 35**  
**Hyrja në fuqi dhe zbatimi**

Kjo rregullore miratohet me vendim të Këshillit Drejtues të AKEP dhe hyn në fuqi duke filluar nga data 1 janar 2027.

# **ANEKS 1. REGJISTRIMI I DOMAINEVE “.GOV.AL, .MIL.AL, .AL”<sup>1</sup>**

## **1. Roli i AKEP si Regjistrues**

AKEP ushtron i vetëm rolin e regjistruesit për nëndomain-et “.gov.al” dhe “.mil.al”, me qëllim garantimin dhe mbrojtjen e interesit publik, sigurisë kombëtare, integritetit institucional dhe besueshmërisë së komunikimeve elektronike të organeve shtetërore dhe të strukturave të mbrojtjes.

Regjistrimi i domain-eve në nëndomain-et “.gov.al” dhe “.mil.al” kryhet vetëm nga AKEP dhe nuk mund të realizohet nëpërmjet regjistruesve të tjerë të akredituar.

Institucionet publike qendrore dhe vendore, institucionet e pavarura si dhe strukturat e mbrojtjes kanë të drejtë të zgjedhin për të regjistruar domain-e edhe në zonën “.al”, pranë AKEP ose regjistruesve të akredituar, në përputhje me përcaktimet e kësaj rregulloreje.

## **2. Kushtet për regjistrim**

- a. Regjistrimi i një emri domain-i në nëndomain-et “.gov.al” dhe “.mil.al” kryhet vetëm nëse aplikuesi provon se i përket kategorisë së subjekteve të përcaktuara përkatësisht për secilin nëndomain sipas kësaj rregulloreje.
- b. Aplikimi për regjistrim duhet të shoqërohet me dokumentacionin mbështetës që vërteton përmbushjen e kushteve të përcaktuara në këtë rregullore.

## **3. Rregulla për nëndomain-in “.gov.al”**

- a. Nëndomain-i “.gov.al” është i rezervuar për institucionet shtetërore të Republikës së Shqipërisë.
- b. Emri i domain-it për të cilin aplikohet duhet:
  - i. të përputhet plotësisht ose pjesërisht me emrin e institucionit aplikues, ose
  - ii. të lidhet me një projekt institucional të ndërmarrë nga institucioni aplikues.
- c. Aplikimi duhet të shoqërohet me dokumentacion mbështetës që provon lidhjen e emrit të domain-it me institucionin ose projektin përkatës.

## **4. Rregulla për nëndomain-in “.mil.al”**

- a. Nëndomain-i “.mil.al” është i rezervuar për strukturat në përbërje të sistemit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.
- b. Emri i domain-it për të cilin aplikohet duhet:
  - i. të përputhet plotësisht ose pjesërisht me emrin e strukturës aplikues, ose
  - ii. të lidhet me një projekt institucional të ndërmarrë nga struktura aplikues.

---

<sup>1</sup> Institucionet publike qendrore dhe vendore, institucionet e pavarura si dhe strukturat e mbrojtjes kanë të drejtë të zgjedhin për të regjistruar domain-e edhe në zonën “.al”, pranë AKEP ose regjistruesve të akredituar, në përputhje me përcaktimet e kësaj rregulloreje.

- c. Aplikimi duhet të shoqërohet me dokumentacion mbështetës që provon lidhjen e emrit të domain-it me institucionin ose projektin përkatës.

## **5. Kërkesat për veprime mbi nëndomain-et “.gov.al” dhe “.mil.al” pranë AKEP**

- a. Kërkesat për regjistrim, transferim, modifikim ose mbyllje të nëndomain-eve “.gov.al” dhe “.mil.al” i drejtohen AKEP në format e përcaktuara në këtë Rregullore, te cilat mund të jenë shkresore ose elektronike.
- b. AKEP përcakton formatet elektronike të kërkesave për veprime mbi domain-et, të cilat përfshijnë, sipas rastit:
  - i. regjistrimin e domain-it;
  - ii. modifikimin teknik;
  - iii. transferimin e zotëruesit;
  - iv. transferimin e administrimit;
  - v. përditësimin e të dhënave;
  - vi. mbylljen e domain-it.
- c. Specifikimet teknike dhe përmbajtja e këtyre kërkesave publikohen nga AKEP në faqen zyrtare të internetit <https://akep.al/>.

## **6. Procedura e regjistrimit të nëndomain-eve “.gov.al” dhe “.mil.al”**

- a. Aplikimi për regjistrimin e një emri domain-i në nëndomain-et “.gov.al” dhe “.mil.al” paraqitet në mënyrë elektronike pranë AKEP.
- b. Aplikuesi paraqet në formë elektronike:
  - i. të dhënat e kërkuara në sistem;
  - ii. dokumentacionin mbështetës.
- c. AKEP verifikon aplikimin dhe komunikon me aplikuesin përmes mjeteve elektronike ose shkresore.
- d. Në rast përmbushjeje të kushteve, AKEP njofton aplikuesin për kryerjen e pagesës.
- e. Regjistrimi kryhet pas konfirmimit të pagesës.

## **7. Afatet e trajtimit të kërkesave**

- a. Afati për regjistrimin e domain-eve në nëndomain-et “.gov.al” dhe “.mil.al” është deri në 3 (tre) ditë pune nga momenti i paraqitjes së të dhënave të plotë.
- b. Afati për modifikimin, transferimin ose mbylljen e domain-eve në nëndomain-et “.gov.al” dhe “.mil.al” është deri në 3 (tre) ditë pune nga momenti i paraqitjes së dokumentacionit të plotë.
- c. Në rast se aplikimi ka mangësi në dokumentacion apo të dhënat e depozituara janë të pasakta, aplikuesi ka të drejtë të riplotësojë ose korrigjojë të dhënat e kërkuara pas kërkesës së AKEP për këtë qëllim.
- d. Afati për riplotësimin ose korrigjimin e të dhënave të aplikimit për regjistrim është deri në 3 (tre) ditë pune dhe lejohet vetëm një (1) herë.
- e. Gjatë kësaj periudhe, emri i domain-it nuk mund të regjistrohet nga një aplikues tjetër.
- f. Nëse brenda këtij afati aplikuesi nuk riplotëson ose korrigjon të dhënat e kërkuara, emri i domain-it konsiderohet i lirë.
- g. Në rast mospagese të detyrimeve të parashikuara në këtë Rregullore, AKEP bën bllokimin e emrit të domain-it për një periudhë 30 (tridhjetë) ditë kalendrike. Gjatë kësaj periudhe, zotëruesi ruan të drejtën e rihapjes së emrit ekzistues duke kryer pagesën përkatëse.

## **8. Pagesat për veprimet me domain-et pranë AKEP**

Pagesat dhe afatet për:

- a. regjistrimin
- b. fshirjen
- c. transferimin
- d. modifikim teknik

që lidhet me një emër domain-i pranë AKEP, përcaktohen me vendim të Këshillit Drejtues të AKEP dhe do të aplikohen me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje.

## ANEKS 2. AKREDITIMI DHE DETYRIMET E REGJISTRUESIT

### 1. Kushtet dhe dokumentacioni i nevojshem per akreditimin e regjistruesit.

Regjistruesi për të marrë të drejtën e regjistrimit të domain-eve në zonën .al duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

- a. të ushtrojë aktivitet në fushën e Teknologjisë dhe Informacionit dhe Komunikimet Elektronike;
- b. të jetë i regjistruar dhe të ketë status aktiv pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe të ketë në objekt të veprimtarisë së tij “*regjistrimin e domaineve*”;
- c. të ketë të paktën 1 (një) person të diplomuar në fushën e Teknologjisë dhe Informacionit, i cili do të jetë përgjegjës për domain-et .al;
- d. të mos jetë në procedurë falimentimi apo likuidimi;
- e. të jetë i regjistruar pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP), në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në procesin e akreditimit regjistruesi duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- a. një kërkesë me shkrim, të shoqëruar me formularin e aplikimit të plotësuar;
- b. ekstrakti i Regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, (QKB) me status aktiv dhe të rifreskuar, jo më pak se 30 ditë nga data e aplikimit.
- c. kopje të diplomës në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit të punonjësit/ve përgjegjës teknik, si dhe kopje të kontratës së punës që provon marrëdhënien e punës me subjektin aplikues;
- d. vërtetim nga organet kompetente gjyqësore që subjekti aplikues nuk është në procedurë falimentimi apo likuidimi;
- e. kopje të shkresës së njoftimit të depozituar pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP), lidhur me caktimin e nëpunësit për mbrojtjen e të dhënave personale, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Dokumentacioni duhet të paraqitet në formën dhe afatet e përcaktuara nga AKEP, i cili rezervon të drejtën të kërkojë dokumentacion shtesë ose sqarime, në rast se vlerëson se dokumentacioni i paraqitur është i jo i plotë ose i paqartë.

### 2. Procesi i akreditimit për regjistruesit

- a. AKEP shqyrton kërkesën dhe dokumentacionin e paraqitur;
- b. Në rast se dokumentacioni rezulton në përputhje me kërkesat e kësaj Rregulloreje, AKEP procedon me lëshimin e faturës për përmbushjen e detyrimeve financiare;
- c. Pas konfirmimit të pagesës, subjekti aplikues pajiset me Certifikatën e Akreditimit si Regjistrues, e cila nënshkruhet nga titullari i AKEP dhe përmban numrin rendor dhe datën e lëshimit;
- d. Regjistruesi i ri regjistrohet në sistemin e administrimit të domain-eve “.al”, me krijimin e profilit përkatës operacional;
- e. AKEP njofton subjektin aplikues për përfundimin me sukses të procedurës së akreditimit, duke i vënë në dispozicion kredencialet e aksesit dhe dokumentacionin teknik të nevojshëm për konfigurimet fillestare;

f. Akreditimi hyn në fuqi në datën e lëshimit të Certifikatës së Akreditimit nga AKEP.

### 3. Të drejtat dhe detyrimet e Regjistruesit

- a. Regjistruesi ka të drejtë të regjistrojë domain name vetëm në zonat .al, .com.al, .net.al, .org.al, edu.al;
- b. Subjekti që kërkon të akreditohet si regjistrues paguan për AKEP tarifën e shpenzimeve administrative të procesit të Regjistrimit;
- c. Regjistruesi paguan një tarifë vjetore në AKEP që të veprojë si Regjistrues. Per regjistruesit qe regjistrohen për herë të parë kjo tarifë llogaritet në mënyrë proporcionale me pjesën e mbetur të vitit.
- d. Regjistruesi për herë të parë blen të pakten 1000 Kredite.
- e. Regjistruesi duhet të rimbushë llogarinë e tij pranë Regjistrimit. Çdo rimbushje do ketë vlerën minimale 500 kredite.
- f. Regjistrimi dhe rinovimi i një domain-i për një periudhë 1 (një) vjecare do të ketë vlerën e 1 (një) krediti.
- g. Vlerat përkatëse për procesin e Regjistrimit, për tarifën vjetore dhe çmimi për 1 (një) kredit do të përcaktohen me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP;
- h. Regjistruesi duhet të vërë në dispozicion të AKEP një numër telefoni të arritshëm për 24 orë në 7 ditë kalendarike për 365 ditë të vitit, me qëllim ndjekjen e problemeve teknike dhe operative;
- i. Regjistruesi ka të drejtë të vendosë çmime konkurruese për rregjistrimin e domain name;
- j. Në zbatim të rregullores, regjistruesi, ka detyrimin që të marrë të dhënat e kërkuara nga aplikanti dhe t'i hedhë ato në regjistrin qendror;
- k. Regjistruesi, përgjatë gjithë kohës së tij si regjistrues, duhet të disponojë faqen ëeb të tij me domain .al. Kjo faqe duhet:
  - i. të jetë aktive dhe funksionale;
  - ii. të jetë në gjuhën shqipe në seksionin e faqes ëeb të tij për domainet .al;
  - iii. të ketë të publikuar dhe të përditësuar këtë Rregullore;
  - iv. të ketë të publikuar dhe të përditësuar listën e emrave të ndaluar dhe listën e emrave të rezervuar, siç është miratuar nga AKEP;
  - v. të evidentojë qarte që është i regjistruar pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
  - vi. të ketë të publikuar tarifat për shërbimet që lidhen me domain-et “.al”. Tarifat duhet të jenë të qarta dhe të ndara nga tarifa të tjera që mund të aplikojnë Regjistruesit.
  - vii. të ofrojë mundësinë e kërimit për domain .al, brenda 30 ditëve nga regjistrimi në AKEP. Kërkimi nuk mund t'i ofrohet paleve të treta për përdorim.

Mospërbushja e secilit prej detyrimeve të mësipërme, çon fillimisht në paralajmërimin e Regjistruesit nga AKEP dhe në rast përsëritje, përbën shkak për revokimin e regjistrimit nga AKEP.

### 4. Raportimi periodik i regjistruesve.

Regjistruesit janë të detyruar, brenda dates 1 mars të çdo viti, të paraqesin pranë AKEP një raport me shkrim per vitin e mëparshem, i cili duhet të përmabjë:

- a. Informacionin mbi problematikat e hasura gjatë administrimit dhe regjistrimit të emrave të domain-eve nën zonën “.al”, të shoqëruar kur është e nevojshme, me dokumentacion mbështetës për qëllime sqaruese;

- b. Listën e tarifave të aplikuara për shërbimet që lidhen me domain-et “.al. Këto tarifa duhet të paraqiten të ndara dhe të identifikueshme qartë nga çdo tarifë tjetër që Regjistruesi mund të aplikojë për shërbime shtesë;
- c. Çdo informacion tjetër të kërkuar nga AKEP, i nevojshëm për ushtrimin e funksionit të monitorimit, mbikëqyrjes dhe verifikimit të përputhshmërisë së veprimtarisë së Regjistruesve me këtë Rregullore dhe legjislacionin në fuqi.

Mosrespektimi i detyrimit për raportim periodik, sipas pikës 5 të këtij Aneksi, përbën shkelje të detyrimeve të akreditimit dhe mund të përbëjë shkak për fillimin e procedurës për pezullimin ose revokimin e akreditimit, në përputhje me përcaktimet e kësaj Rregulloreje.

#### **5. Revokimi dhe Çregjistrimi i Çertifikatës së Regjistruesit nga AKEP.**

- a. Kur regjistruesi mbyll aktivitetin apo do të bëjë bashkim me një subjekt tjetër, është i detyruar të njoftojë AKEP-in minimumi 50 ditë para.
- b. AKEP verifikon plotësimin e detyrimeve ligjore dhe financiare të regjistruesit dhe bën çregjistrimin e tij nga regjistri;
- c. Nëse regjistruesi ka më shumë se 3 muaj që nuk shlyen detyrimet financiare ndaj regjistrisë, AKEP-it i lind e drejta e revokimit të akreditimit të këtij regjistruesi.
- d. Regjistruesi të cilit i revokohet akreditimi nuk do të përdorë apo ruajë asnjë informacion konfidencial ose të dhëna të aplikuesve apo zotëruesve të domain-eve.
- e. Moszbatimi i kushteve të kësaj rregullore përbën bazë për revokimin e akreditimit të regjistruesit, pas përfundimit të procedurës administrative përkatëse dhe garantimit të së drejtës për t'u dëgjuar.

## PYETJE PËR KËSHILLIM PUBLIK

Palët e interesuara ftohen të japin komente dhe sugjerime për pyetjet e këshillimit publik të paraqitura më poshtë, si dhe për çdo aspekt tjetër të lidhur me këtë projekt-rregullore. Pyetjet për këshillim publik janë grupuar sipas strukturës së dokumentit dhe çështjeve kryesore me interes të vecantë në kontekstin e zbatimit të rregullave për administrimin e domain-ve.

1. A jeni dakord me parashikimin e pikës 4 të nenit 6 sipas të cilës “Institucionet publike qendrore dhe vendore, institucionet e pavarura si dhe strukturat e mbrojtjes kanë të drejtë të regjistrojnë domain-e në zonën “.al”, pranë AKEP ose regjistruarve të akredituar”.

Apo

“Institucionet publike qendrore dhe vendore, institucionet e pavarura si dhe strukturat e mbrojtjes regjistrojnë domain-e në zonën “.al”, vetëm pranë AKEP

2. A jeni dakord me parashikimet e pikës 2 të nenit 31 të Rregullores, që përcaktojnë “Të dhënat e zotëruesve të një emri domain, që ndodhen në regjistrin elektronik të domain-eve, konsiderohen konfidenciale dhe nuk u jepen palëve të treta, përveç rasteve përjashtimore të përcaktuara në këtë rregullore...”

Apo

“Të dhënat e zotëruesve të një emri domain në zonën “.al”, duhen të bëhen publike”

3. Në vlerësimin tuaj, a duhet që AKEP të përcaktojë një çmim tavan për tregun me pakicë të domaineve?
4. A janë të mjaftueshme masat aktuale administrative të përcaktuara ndaj regjistruarve si paralajmërim, pezullim, revokim për të garantuar respektimin e kësaj rregulloreje nga ana e tyre apo është e nevojshme të parashikohet edhe tjetër dënim administrativ?

Në komentet/përgjigjet e dhëna, palët rekomandohet të përfshijnë edhe argumentim për përgjigjet/komentet si dhe sugjerime për përmirësimin e dokumentit.

Procesi i këshillimit publik për dokumentin “Projekt-rregullore Për Regjistrimin dhe Administrimin e Emrave të Domain-eve “.al, .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al”, do të kryhet për një periudhë 30 ditore nga data e publikimit të dokumentit në faqen e internetit të AKEP, dhe palët e interesuara mund të dërgojnë komentet me shkrim në AKEP si më poshtë:

- në formë shkresore në adresën Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), Rr. “Reshit Çollaku”, Tiranë.

- në formë elektronike me email në adresën [info@akep.al](mailto:info@akep.al).